

Besim Qorri

VITI i II — NANDUER 1929 — Nr. 1.

NORMALISTI

Jo në dijen, por në
vullnetin e fortë
qëndron vlera
e njeriut.

HERBART.

Drejtimi:
E përkohëshmeja "NORMALISTI",
Shkolla Normale
Elbasan.

Shtypshkronja „SAIDE“ Elbasan
1930

DHURUAR

NGA

BESIM

QORRI

M b r e n d i j a

Pak fjalë mbi ndeshkimet.
Nji lu'e Vjeshte.
Provë-mësimi (Histori)
Forcimi Fizik
Provë-mësimi (Gramatikë)
Qysh u-bëra Pr. zator.
Rreth ditës së Flamurit.
Të përshëndeturit.
Lajme Sportive.

E përkohëshmjja * N O R M A L I S T I . D E L N J I H E R Ë N Ë M U E J .

E botojnë nxënësit e Normales.

Editor:	Q. Shehu '30	ndihmës	R. Hoxha '31
Sekretar:	R. Spahiu '30	" "	T. Gusho '31
Arkëtar:	E. Shtëpani '30	" "	I. Shimili '32

P a j t i m i : për nandë numra 3 Fr. ari
Nji numër kushton 1 Kor.

VITI i II — NANDUER 1929 — Nr. 1.

NORMALISTI

Jo në dijën, por në
vullnetin e fortë
qëndron vlera
e njeriut.

HERBART.

Drejtimi:
E përkohëshme "NORMALISTI,"
Shkolla Normale
Elbasan.

Shtypshkronja „SAIDE“ Elbasan

1930

M brendija

Pak fjalë mbi ndeshkimet.

Nji lu'e Vjeshte.

Provë-mësimi (Histori)

Forcimi Fizik

Provë-mësimi (Gramatikë)

Qysh u-bëra Pr. zator.

Rreth ditës së Flamurit.

Të përshëndeturit.

Lajme Sportive.

E përkohëshmjja "NORMALISTI," DEL NJI HERË NË MUEJ.

E botojnë nxënsit e Normales.

Editor: Q. Shehu '30 ndihmës R. Hoxha '31
Sekretar: R. Spahiu '30 " " T. Gusho '31
Arkëtar: E. Shtëpani '30 " " I. Shimili '32

**Pajtimi: për nandë numra 3 Fr. ari
Nji numër kushton 1 Kor.**

Pak fjalë mbi ndeshkimet.

Ndeshkimet duhen përdorë me vend dhe jo n' ate mnyrë si janë përdorë në kohna të maparshme.

Nji nder qyshke, qi i ndihmojnë mësuesit me u hi në zemër fmijve, me fitue nderimin e dashtnin e tyne, është drejtsia. Mirpo, per me mujtë me i gjikue ngjarjet drejtë, duhet me qenë gjakftoftë, mos me dhanë vendime në valë t' idhnimit per mos me fye kshtu drejtsin, e cilla në zemër të nxânsve duhet të mbesi e kulluet edhe e pa peçatun. Nder dyshime, ku fort kollaj mund të bâhen padrejtsi, është shumë mâ mirë per mësuesin të mos ndeshkojë fare se sa të ndeshkojë nji të pa faj.

Qillon shpesh herë qi mësuesi, i shtrënguem në ndonji mësım me u sjellë shpinën nxânsve, ndigjon mbrapa ndonji shamatë të voglë, të qeshun etj . . . e i zemruem për nji herë sillet e i drejtohet nji nxânsi, qi ndoshta n' at kohë sjell kryet mbrapa kot, dhe i nep ndonji ndeshkim tue kujtue se ai është shkaku i atij të qeshuni a i asaj shamate!

Shka ndodhë atëherë? Nxânsi i pa faj bjerr nderimin qi ka në mësuesin, pse, si dihet dhe prej parafytyrimevet, qi na kanë mbetë prej kohës së fminis, nxânsi e kujton mësuesin të zotin në çdo pikpamje, si nji babë e pra si njeri i drejtë; përkundrazi, ai qi me të vërtetë kishte faj, merr zemër me punue dhe herë të tjera aso punësh, pse shpreson se vetë me dñelpni do të shpëtojë e për mâ tepër kërkon qi të qoshi e të knaqet në dnimin e shokit të pa faj. Për kto arsye pra mësuesi lypet të matet mirë përpara se të caktojë nji nxânës si fajtuer; me nji të kqyrun duhet të lexojë ftyrat e tyne dhe nëpër kto sheje të gjejë fajtorin e vërtetë **pa pasë nevojë me pyetë të tjerë nxânës**. Dhe, në qoftë se mësuesi ndonji herë do t' u gabote në të gjetunit e fajtorit, mâ mirë do t' ishte me anë të mënyrve, të cillat s' duhet t' i mungojnë, m' e rryfe gabimin e tij, pse atëhere do të fitonte simpathin e besnin e nxânsve.

N' anë tjetër mësuesi nuk duhet ta randojë dorën me ndeshkime gjithë nduersh. Kto mënyrë ndeshkimesh përdroeshin në

M b r e n d i j a

Pak fjalë mbi ndeshkimet.

Nji lu'e Vjeshte.

Provë-mësimi (Histori)

Forcimi Fizik

Provë-mësimi (Gramatikë)

Qysh u-bëra Pr. zator.

Rreth ditës së Flamurit.

Të përshëndeturit.

Lajme Sportive.

E përkohëshmjja "NORMALISTI," DEL NJI HERË NË MUEJ.

E botojnë nxënsit e Normales.

Editor:	Q. Shehu '30	ndihmës	R. Hoxha '31
Sekretar:	R. Spahiu '30	" "	T. Gusho '31
Arkëtar:	E. Shtëpani '30	" "	I. Shimili '32

Pajtimi: për nandë numra 3 Fr. ari
Nji numër kushton 1 Kor.

Pak fjalë mbi ndeshkimet.

Ndeshkimet duhen përdorë me vend dhe jo n' ate mnyrë si janë përdorë në kohna të maparshme.

Nji nder qyshke, qi i ndihmojnë mësuesit me u hi në zemër fmijve, me fitue nderimin e dashtnin e tyne, është drejtsia. Mirpo, per me mujtë me i gjikue ngjarjet drejtë, duhet me qenë gjakftoftë, mos me dhanë vendime në valë t' idhnimit per mos me fye kшту drejtsin, e cilla në zemër të nxânsve duhet të mbesi e kulluet edhe e pa peçatun. Nder dyshime, ku fort kollaj mund të bâhen padrejtsi, është shumë mâ mirë per mësuesin të mos ndeshkojë fare se sa të ndeshkojë nji të pa faj.

Qillon shpesh herë qi mësuesi, i shtrënguem në ndonji mësim me u sjellë shpinën nxânsve, ndigjon mbrapa ndonji shamatë të voglë, të qeshun etj . . . e i zemruem për nji herë sillet e i drejtohet nji nxânsi, qi ndoshta n' at kohë sjell kryet mbrapa kot, dhe i nep ndonji ndeshkim tue kujtue se ai është shkaku i atij të qeshuni a i asaj shamate !

Shka ndodhë atëherë ? Nxânsi i pa faj bjerr nderimin qi ka në mësuesin, pse, si dihet dhe prej parafytyrimevet, qi na kanë mbetë prej kohës së fminis, nxansi e kujton mësuesin të zotin në çdo pikpamje, si nji babë e pra si njeri i drejtë; përkundrazi, ai qi me të vërtetë kishte faj, merr zemër me punue dhe herë të tjera aso punësh, pse shpreson se vetë me dnelpni do të shpëtojë e për mâ tepër kërkon qi të qoshi e të knaqet në dnimin e shokit të pa faj. Për kto arrsyje pra mësuesi lypet të matet mirë përpara se të caktojë nji nxânës si fajtuer; me nji të kqyrun duhet të lexojë ftyrat e tyne dhe nëpër kto sheje të gjejë fajtorin e vërtetë **pa pasë nevojë me pyetë të tjerë nxânës**. Dhe, në qoftë se mësuesi ndonji herë do t' u gabote në të gjetunit e fajtorit, mâ mirë do t' ishte me anë të mënyrve, të cillat s' duhet t' i mungojnë, m' e rryfe gabimin e tij, pse atëhere do të fitonte simpahin e besnin e nxânsve.

N' anë tjetër mësuesi nuk duhet ta randojë dorën me ndeshkime gjithë nduersh. Kto mënyrë ndeshkimesh përdroeshin në

kohë të maparshme kur mësuesi ishte mnera e jo ati i dashtun i nxânsve, atëhere kur msuesat nuk kursejshin dajakun, të përzanët prej shkollë e fjalë tepër t'ashpra, për me mujtë me shtrëngue shpirtin e nxânsve në ndigjesë, në zakone të mira e në dashtni për msime, kje n' ktë kohë qi nxânsit drojshin mësuesin si mordën e me shkue në shkollë i u dukte si me shkue në burg.

Cili qe fitimi i ksaj metode? Mujten mësuesat me formue njerzë si duhet? Jo, por njerz të frikshëm, hipokritë, rrencakë etj.

Por kaloi tesh më ajo kohë, sot duhet ndjekë një drejtim tjetër, d. m. th. duhet shkue tue veprue prej së **mbrendshmi jashtë**, me i hi në zemër fmis e m' e drejtue ku duhet e si duhet.

Sot mjafton vetëm një të kqyrun, një qortim në të gjithë klasën, një qortim e kshillë fajtorit, një krahasim me shokë të mirë, të mendshëm e të ndigjueshëm.

Por dhe në qoftë se msuesi, për faje të randa, shtrëngohet me përdorë ndeshkime më të randa, duhet të mendohet mirë, të vështrojë trupin e nxânsve, gjendjen e tij familjare etj., pse p. sh: po qe se lamë një nxânës të vobektë pa ngranë për drekë, do të bájshim një gabim e jo të vogël; pse ai në shtëpi nuk ka me ngranë sa m' u-ngi mirë, prandaj mund të jetë i dobët me shndet dhe mësuesi tue marrë një masë të tillë kundra tij, me doemos do t i sjellin ndonji dam, pse ai, veç qi hutohet e nuk mund të ndjekin mësimit e mbasdrekës, ndoshta i bjen edhe të fikët. Shum më mirë do t' ishte në vend të ktyne ndeshkimeve me përdorë të tjera si b. f. të përjashtuemit e nxânsit prej ndonji shetije etj. .

Por sidomos në klasë t' ulta, n' ato klasë ku fillon fmia të drejtohet prej gabimesh, aty duhen përdorë me masë të madhe. Nuk duhet qi fmija sidomos në kto klasë të ndigjojë orë e ças bër-timë, qortime t' ashpra etj. . . , pse atëhere do t' u-msote me ato fjalë e nuk do të ndinte kurrfarë mbrese, prandaj nuk do të bënte ndonji përmirsim e, në qoftë se ato të vogjel nuk do të hijshin n' udhën e drejtë e të dishiplinës, dhe të mdhaj do të vijojsin po at udhë. Prandaj sot nuk u thohet më fmijev:

— Në qoftë se lueni, do t' u-rrahi, do t' u-qes jasht etj. . .

Mjafton, qi me një randsi të zbutun me ambëlsi t' u thohet: b. f. — Kjeçë tue kallzue jetën e Skanderbeut e ti nuk i ke marrë vesht kto gjâna të bukra. Diftoi ti Aleks çka u-rrfeva.

A shef sa mirë din ky, qi ia ka vù menden?

Ose në klasë më të ulta :

— A nuk të dhimset baba qi punon gjithë ditën me të mbajtë e me të prue ktu në shkollë me nxanë gjithë kto sende ?

Kto qortime janë më të gjata, por nuk ka me qenë nevoja me i përsritë shpesh herë.

Kshtu dhe për një, qi shifet tue ngranë në klasë nuk është nevoja me ia marrë gjasendin e m' e ndeshkue b. f : tue i thënë shkruet një zet herë “ në shkollë nuk duhet me ngranë „ ; më përfundim të mirë do të kishim :

— Duket se Aliu ka u të madhe, sa qi nuk kujton se jemi në klasë ! Ktu pra s' është vend i ngranjes, por i mësimit ! . ,

Kshtu dhe kur mësuesi shfë librin e nxansit tanë shkarravina (dardaleca) nuk duliet t' i bërtasi, por ta qortojë me butsi, pse qejfi i fmis është gjithmonë me shkruet të tilla gjana, prandaj :

— Sa dardaleca ke bënë — i thotë — por asnjë të bukur e të pastër; është mirë me bënë të tilla sende, por jo nder libra, se prishen; më mirë, blei ndonjë radhue e aty bënë për ditë ndonjë dardalec mbas qejfit t' and, pastaj më difto me.

Me këtë mënyrë qortimi nxansi jo vetëm nuk bënë më shkarravina nëpër libra, por dhe ato qi i bënë në fletore mundohet me i bënë pastër e mirë për me i pëlqye mësuesit.

Si këtë kemi shumë rase të tjera, qi ndodhin po thue shpesh, por në të gjitha mësuesi, si thamë, nuk do të mundohet me anë të ndeshkimeve trupore me vënë në një rrugë të drejtë shpirtin e vullnetin e nxansve, por, tue veprue prej së mbrendshmi jashtë, t' u fitojë zemrën e t' i bëjë të largohen prej çdo gjëje qi s' është e mirë. Në këtë mënyrë do të kemi nxansa t' ambël, të dashtun ndaj mësuesin e mësimit, nxansa, qi do të kishin në qejf më tepër shkollën se shtëpin, e të tillë qi mësuesi porsa të thonë. — Të diftojë kush foli, qeshi etj. — tue besue në butsin e dashtnin e tij të thonë “ Unë „. Ky është qëllimi, të cillit duhet t' ia mbërritë mësuesi me formue njerzë si duhet, por kjo punë është mjaft e vshtirë, prandaj me arsye të madhe thohet se mësuesi lind dhe me të vshtirë bëhet.

Z. N. Pali '30

Nji lule Vjeshte

(në prozë)

e

Poetit t' onë, At Gjergj Fishtës.

Ah, të zhduki vdekja, e cila shkon si ke të pasunit ashtu edhe ke të vorfnit, pa marrë para sysh asnji send. Nuk shofin më ata dy syt e tu, me të cilët dikur shifshë qiellin e pjerun bashkë me yj, që dukën sikur vërejnë punët e njerzvet. Gjithashtu tash nuk ndëgjohen më fjalët e urta e t' ambla të tuat, pse është shterrë ai zâ i bukur, që u përngjante tingujvet të njëj lyrës, kur i bje një i mësuem. Tash je pluhun e mbrenda në vorr t' errët. Sot vorri i yt ka humbë në mest të barishtavet t' egra Edhe kryqi dullijet, që ta pat vumë ke kryt një zemerdhimbshëm, s' duket më Trishtimin e vorrit nuk ka se kush me ta lehtësue, veçse zani i vajtimit të ndonjij huti të natës, që rrënkon dhimbshëm në dritë të hanzës. Edhe ai grumbull' i gurëvet, që të shoqnon tue t' u-randuem mbi vorr, mjaft i frigshëm ka me i u-dukë edhe atij më gjaksorit. të cilit mund t' i bijë udha me shkue andej

Por kjo vdekje nuk të ka humbë fare nga gjithësija, se pjesa më e mirë e jotja shpirti i yt, ka fluturue në qiell, afër Perëndis, aty ku shkon çdo shpirt i kulluet. Prandaj, kur mora vesh se vdiqe në moshën t' ande më të mirë, nuk kam qamë. E dij se shpirti i pastër i yt nuk mundi të qëndrojë në këtë botë të mbrapshtë e të mbushun plot me të kqija, por fluturoi n' atë jetë e përanë të Gjithfuqishmit. Pra ti nuk ishe për këtë botë, por për atë t' jetrën.

E tash, që jam tue shkruem në kto letra, ti, kushedi, munt të jesh tue shetitë nëpër lulishtat e pavdekshme të Parajzës; e aty vallzon bashkë me engje, tue këndue lavde Zotit. Ose munt që tash ndodhesh e habitun prej të vërejtunavet që bân mbi punët e Perëndis, e cila prej kurrgjās e krijoi gjithë rruzullimin, tue e larguem errsinën me fuqin e pakrahasueshme të vetën. Aty pra, afër Zotit, ti gjindesh e kaplueme prej dritës së hyjnueshme e i vëren të vërtetat e kthiellta, që Ai ua lã njerzvet errët nëpër librat e shenjta.

Shum herë, i lodhun prej studimit e prej mallit që kam, dal në dritore e vërej hapsinën e mbushun me hyj, të cilët duken se të gjithë shëkojnë, si sy Zoti, punët e liga të ksaj bote. Ku ta shoh një hyll më të ndritshëm, aty më ngjan se ti gjindesh; dhe atëhere i ngul syt pa dá n' at hyll e të thras me emën; por të thirrunit t' im m' i përgjigjet një vajtim i bylbylit, i cili, ndoshta, munt të jetë tue qamë hallin e vet ose zogjt e dashtun; mirëpo mue më duket se bisedoj me ty!

Nuk vdekka kurrë i miri, se ai gjithmonë na rri në mend, e kujtimi i tij na nxit edhe në, që të bájme punë të mira. Kështu edhe Leka i math, tue pasë si shembull trimnin e Akilehtit, mundi t' i dalë qëllimit në krye ashtu si dashti. Por edhe unë, me gjithë që kam me u-ndeshë në pengime, kam për të të pasë gjithmonë në mend për të mirat e tua; edhe që me zemër të ndez me po betohem mbi vorr t' and se do të mbaj besën e dhanme: me mprojtë atme e fë; me i ndihmuem të dobtit; mos me i pergdhelun ata që janë më të fortë; kur bje puna, me e thëhun të drejtën; mos me i u-shmangë cakat, në të cilin dëshron të hapet mendja e zemra e arsyshme dhe e çiltër, edhe mos me u-ligshtuem në të vështirat e ksaj jete. Ai kryq dullijet, që ta zbut mnerën e vorrit, ka për të më qenë qëndër ndër mundimet, Edhe Engjëlli, i cili ka me të ruejtë për mos me të trazuem kush, deri sa të shuhet rruzullimi, ka për të më qenë Zanë e ka për me më nxitë që të flas kundër vesit të njerzvet. Me frymzimim e tij (t' êngjëllit) do të mundem me bëmë kangë, me të cilat i dëftoj botës trimnin e Shqiptarit. Me këto kangë ty kam për ta ngrefun një përmen-dore, që ka me qëndruem gjithmonë e patundshme, se nuk do të munt t' i bájne gjá as ernat e shtërgatat më të tmershme.

E atëhere Zanat e bjeshkvet kanë me ta zbukuruem vorrin t' and, tue ta përqarkuem me lule e me selvija të blerta, Nden hijen e ktyne shtektarët e lodhunë, që ndalen për me pushuem pak, kanë me kuptuem se çfarë njeri i naltë ást mbyllë n' atë vorr. Mirëpo kta, kur shkojnë ke shtëpija, kanë me u kallzuem fmijvet të tyne të gjitha ato që ndëgjuen e ndien për ty. Fmijt e malsorëvet mandej kanë për ta kënduem me kangë emnin t' and, i cili ka me bëmë të jehojnë vrrini e bjeshka. Edhe ky emni i yt ka me u-shkruem me shkronja barijsh nëpër lisa, që

kanë me qëndruem me shekuj, se ata përmbajnë emnin t' and; e kshhtë nipat më të vonë kanë me e kënduem atë deri sa të jetë jeta.

SHKELZENI *28.

Elbasan, 1928.

Provë-mësimi

Dhanë në rendin e IV të të Shkollës Ushtrimore

Thema : Mësim jete (Histori- Dita 28 Nandner)

Sikurse në çdo mësim tjetër, ashtu edhe në mësimin e historis, para se të fillohet mësimi i mirëfilltë, duhet bëmë një hyrje a paratitje. Kjo mund të bëhet në shum mënyra e sa për në këte rasë mund të vlejë edhe kjo : Kam pamë disa prej jush, që po bëjnë rrobe, pantallona të zeza e këmisha të kuqe; pse po i bëni ju këto rrobe ? (Për ditën e Fiamurit). Po a e dini ju pse e festojmë ne kte ditë ? (E festojmë se në këte ditë është ngritë për herën e parë Flamuri i jonë). Pse kush ka qenë më përpara në vendin t' onë ? (Tyrqia). Po gjithnji Tyrqit kanë qenë në Shqipni, nuk paskan qenë ndonji herë më vehte Shqiptarët ? (Kanë qenë edhe më përpara mëvehte në kohën e Skënderbeut) Tashi mësuasi zë e flet pak mbi Skënderben : Skënderbeu ka qenë një burr mjaft i zoti, trim, luftoi shumë herë me Tyrqit dhe kurdoherë i pat mundë. Ata e patën marrë mjaft frikë Skënderben, prandaj deri sa qe aji gjallë nuk hynë në Shqipni. Si vdiq ky burr i math për vendin t' onë, erdhën Tyrqit këtu. Mbasandaj u kallzohet sundimi i Tyrqis në Shqipni, mundimet e vuejtjet e Shqiptarvet prej Tyrqvet, të shtrënguemit e Shqiptarvet që të mos hapin Shkolla Shqipe, të marrunit e djelmvet ushtarë e të dërguemit e tyne shumë larg prej Shqipnis, mundimet e këtyne të fundit larg atdheut të vet e në fund edhe kryengritjet e Shqiptarvet kundra Tyrqis.

Si të fitojnë nxansit një kuptim të kthjellët mbi gjithë sa u-thanë sipër, u njohtohet se përveç Shqipnis kanë qenë pushtue prej Tyrqvet edhe shumë shtete të tjerë, si Sërbia, Greqia, Mal' i zi, Bullgaria e Bosnja; u kallzohet se edhe këto po vuejshin mjaft prej Tyrqvet, prandaj s' prajshin tue bā kryengritje, sikurse po bëjshin edhe Shqiptarët. U thohet se Tyrqia ishte mjaft e madhe, por me gjithë atë kryengritjet, që bëheshin sa në Shqipni, sa

në Greqi, sa në Sërbë, etj e dobsuen mjaft.

Gjithë ky vend, ku banojnë Shqiptarët, Serbët, Grekët, Malezest, Bosnjakët e Bullgarët quhet me një emën "Ballkan". Pra ç'farë emni mund t' i apim këtyne shteteve që gjinden në Ballkan? (Shtete Ballkanikë). Të gjithë këto Shtetet Ballkanike një nga një patën luftue mjaft herë me Tyrqit, por asnjë nuk mundi me bënë gjë e, tue e pa se kështu të ndamë kishin me mbetë gjithnji nën zgjedhën e Tyrqis, u-bashkuen ndërmjet tyne, se bashkimi bënë fuqin, e të gjithë së bashku, si një trup i pandamë, i ranë Tyrqis. Ajo e shkatarrueme prej luftavet të shumta, që kishte bënë me Shtetet e Ballkanit u-shtrëngue t' iki e të shporret fare prej këndej.

Të gjithë Shqiptaret, që gjindeshin mbrenda edhe jasht Shqipnis, u-gëzuen aqë sa s' bëhet, kur iku Tyrqija prej Ballkanit. Po a e dini ju se ç' deshën t' na bëjnë neve fqijt t' onë? Këto të shkretë nuk mjaftojshin vetëm me atë që shpëtuen, por dojshin me pushtue edhe vendet e hueja: deshën pra ta ndajnë tokën e Shqiptarvet ndërmjet 'tyne (këtu u kallzohet edhe si deshën me e nda). Kur e muerën vesht Shqiptarët qëllimin e keq, që kishin fqijt për vendin t' onë, me të shpejtë sejcili qytet dërgoi të parët e vet në qytetin e Vlonës, ku të mbledhun trumë nën kryesin e Ismail Qemalit (u kallzohen edhe disa emna njerzish të tjerë të përmendëm, qi muerën pjesë n' atë mbledhje e sidomos ata që ka dërgue vendi ku gjindet nxânsi) filluen me u-përpjekë për shpëtimin e Shqipnis tue u-ankue ke shtetet e mëdhoja t' Evropës, si ke Anglia, Gjermania, etj., që ta njëfshin edhe ato vetqeverimin e Shqipnis. Këtu nxânsit dëftejnë, tue u-nxitë prej mësuësit, se jo vetëm shqiptarët, që gjindeshin në Shqipni, por edhe ata, që gjindeshin jasht kësaj, tue pa largimin e Tyrqis prej Ballkanit, s' prajshin së punuemi për të mirën e atdheut të 'tyne të dashtëm. Plaku Shqiptar, Ismail Qemali, s'priti më, po në mest të kësaj trazine kaq të madhe ngriti Flamurin e Shqipnis më 28 Nanduer të vitit 1912. Sa gëzim i math ishte për Shqiptarët, kur shifshin flamurin e 'tyne kuq e zi, që po valonte n' erë; Kjo shejë u kujtonte atyne gjithë vuejtjet, që kishin pësue prej Tyrqvet, Shumë vetë nga gëzimi i math qajshin e shumë të tjerve u dukesh sikur ishin n' andërr, pse asnjë nuk i shkonte mendja se do t' ia mbërrinte asaj dite aqë të lumnueshme

Tashti Shqiptarvet iu dukesh sekur kishin shpëtue prej zinxhirit.

Ky është pra shkaku që e festojmë ne kaq fort këtë ditë. Të gjithë Shqiptarët duhet ta festojnë ditën e Flamurit më tepër se gjithë festat e tjera, pse kjo është ajo ditë, që Shqiptarët shpëtuen prej zgjedhës së Tyrqisë, prej asaj zgjedhje që e pat shkretue fare vendin t' onë.

Në fund do të ngrihen disa nxënës që, të dëftejnë shka kanë mbajtur mend nga ato që u folën në këte orë, e, në qoftë se del koha, flitet edhe për zgjedhën Serbe e Greke në Kosovë e Çamëri, për mundimet e Shqiptarvet në këto vende e për shpresën e shpëtimit të 'tyne.

Qëllimi i këtij mësimi do të jetë më tepër të njallosunit e ndjenjës kombëtare në shpirtin e nxënësve; për këte arsye ky (mësim) nuk do t' epet si një konferencë e mbajtur prej një njeriu të naltë, por aty-këtu, ku të shifet nevoja, do të nxiten nxënësit të mendojnë e të flasin vetë për mbi mundimet e mëdhoja, që kanë hekë Shqiptarët deri sa e fituen pavarësin e t'yne. Gjithashtu nuk duhet lënë më një anë edhe detyra, që kanë për të përmbushë nxënësit, kur të rriten, ndaj Atdhën.

Q. Shehu "30.,

Locke

Forcimi Fizik

Një nga zakonet për shëndetin e njeriut e sidomos për atë të fëmijvet, është të qëndruarit shpesh herë jashtë n'ajrin e pastërtë e sa të jetë e mundur fare pak afër zjarrit, qoftë edhe në dimër. Kështu fëmija do të bëjë zakon të ftohtit, shiun, borën, diellin e vapën. Pa këtë zakon njeriu në shumë raste të jetës nuk do të shofij shërbime të mëdha prej trupit të tij. Ky zakon fitohet që prej së vogli e shkallë shkallë, pse kur harrin njeriu moshën e pjekur, është tepër vonë dhe ka vështirësi.

Në qoftë se do të këshilloja që fëmija të dilte jashtë n' erë e në diell për të lojtur, nuk jam i sigurtë se do të mbahesha vesh dhe do të ndiqej kjo këshillë. Do të më bëheshin për këtë propozim shumë kundërshtime, të cilat do të përmblihdeshin në këtë pikë: " fëmijën do t' a nxijë dielli „. Mirëpo, mb' anë tjetër, në qoftë se fëmija rri gjithmonë në hije, në qoftë se nuk e lësh më të dalij n' erë e në diell nga frika se do t' i prishij çeren dielli, kjo është me të vërtetë mënyra më e mirë për t' a bërë

atë një djalë të bukur, por aspak një djalë të punës. Gjithashtu edhe për çupat, për bukurin e të cilavet duhet të kujdesemi më tepër; marr lirin të them që ato, sa më tepër t'i rrahij era, pa ua ndruar fytyrën, aq më të forta do të bëhen edhe sa ma tepër t'ia afrojmë edukatën e tyre edukatës s' ashpër të djemvet, aqë më mirë do të ishte për jetën e tyre të pastajme.

Mveshja

Mveshjet fëmija nuk duhet kurrë t'i ketë të ngushta e si-domos rreth krahanorit.

Të ia lëmë natyrës rritjen e trupit ashtu sikur e ka nisur. Ajo punon vet-vetiu më mirë, më me mjeshtëri se sa ne, që duam dhe pretendojmë ta drejtojmë... Ka shumë fëmijë që kanë mbetur të metë trupërisht prej të lidhurit të fortë në djep e nga barërat e shuma që kanë pirë.

Nga kjo gjë, më duket mua, që shumë veta duhet të largohen e të mos përzjehen për gjera që s' mundin t'i bëjnë; ata duhet të mos e kthejnë natyrën nga udha që ka nisur, duke dashur ata vetë të ndërtojnë pjesët e organet e trupit, për të cilat s' kanë as më të voglën ide se si janë gatuar. Kam parë shumë fëmijë, të cilët kanë vuajtur kaqë tepër prej shtrëngimit të rrobavet, sa s' më durohet të mos them, që ka edhe kreatyra të tjera përveç majmunëve, që nga pakujdesija, a, të thuesh, nga pamëndja kanë vdekur pjellat e tyre duke i pëfqafuar me shtrëngim.

Një kraharor i ngushtë, një marrëfrymje e shkurtër, një e dhënme frymë e dobët dhe e pakë, një trup i krusur, të gjitha këto janë efekte të shkaktuara nga të përdorurit e brezavet, e rrypavet e të rrobavet të ngushta e të shtrënguara. Mjetet e mënyrat që përdoren për t' u dhënë fëmijvet një shtat të stërhollë e të shkathët, sigurisht kanë për përfundim prishjen e trupit. Gjithashtu ushqimi, kur nuk lihet të lëvizij lirisht, shtrëngohet të shpërnda-het në një mënyrë të çnjënjëshme nëpër pjesët e trupit. Pra, duke qënë kështu, përse të çuditemi kur shohim se një sup është poshtë e tja tri më lart ose një ngof m' i shtjelluar nga tja tri?

Qinezët përgjithërisht e kanë për fisnikëri dhe si shënjë bukurije këmbën e vogël. Për këtë gjë çupavet u lidhin e u shtrëngojnë këmbët që prej së vogli që të mos i u rriten.

Kam parë tashti shpejt një palë këpucë kineze, të cilatë më thoshnin se qenë ndërtuar për një grua të shkuar nga mosha : ato ishin aqë të vogla dhe kishin kaqë ndryshim nga këmba e një gruaje të vëndeve t'ona sa që një çupë fare e vogël, po thuaj një fëmijë, do të hiqte mundim të math që ta vishte. Mb'anë tjetër është parë se gratë qineze kanë një shtat të vogël edhe rrojnë fort pak, kurse përkundrazi burrat qinezë kanë po atë shtat dhe harrijnë po atë moshë të burravet të tjerë ! Të shumtën e herës të metat trupore që kanë gratë qineze, rrjedhin nga zakonet e palogjikshëm të shtrëngimit të këmbëve pse me të vërtetë gjaku, duke mos lëvizur lirisht në të gjitha anët, bën që trupi e shëndeti të vuajnë e të pengohen në rritje e sipër. Sa herë neve vetë prej një plage të vogël që kemi patur në këmbë, kemi vuajtur e kemi ndjerë dhëmbje jo vetëm rreth plagës, po në të gjithë këmbën ! Cila është m'e keqe për trupin t'onë sa të shtrënguarit e kraharorit, ku gjëndet zëmra, çerdhja e jetës, në një mënyrë anormale sa të pengohet zgjerimi i tij i lirë ?

Ushqimi

Duhet kujdes edhe n'ushqim. Ky duhet së pari të jetë i pastërtë, jo shumë i përzjerë, të ketë pak sheqer ose më mirë të mos ketë fare : erërat veçanërisht, sikurse çdo pije tjetër nxitëse duhet të ndalohen. Gjithashtu edhe krypa duhet hedhur me përpjesëtim në gjellët, pse goja e jonë mësohet dhe e bën zakon krypën e tepërme, e cila përveç nxitjes së përherëshme t'etjes, mund të prodhojë edhe shumë sëmundje të rrezikshme.

I përunjem mendimit që për fëmijën një copë bukë e zezë, e pjekun mirë, me pak gjalpë përsipër ose thatë, është shumë herë një nga ushqimet më të mira e jam i sigurtë se ky ushqim është i shëndetshëm po thuej sa ai m'i miri e më delikati, dhe, në qoftë se fëmijës ia mësojmë që për së vogli, do të hajë aqë me qejf, sa çdo ushqim tjetër të mirë. Në qoftë se ngjan që fëmijit kërkohet shumë herë bukë jasht drekës e darkës, sikurse ndodh shumë herë në fëmijë, mos i jepni gjë tjetër përveç bukës thatë. Në qoftë se është me të vërtetë urija, që i shtyn të kërkohet bukë e jo kaprica e tyne, buka thatë iu mjafton; dhe në qoftë se nuk kanë uri nuk është nevojë që t'u epet. Prej kësaj dotë kemi dy përfundime të mira : së pari prej zakonisht të bukës thatë, fëmija

do ta hajë gjithënjë me qejf; së dyti nuk do të kemi mundim e të lodhemi duke i thënë atij të hajë më pak ose më thjeshtë. Mbasandaj nuk besoj që të gjithë njerzit të kenë po atë qejf për të ngrënë : disa hanë më dëndur e disa më rrallë.

Por gjëja që di unë, është që shumë njerzë janë bërë hamës prej zakonit e jo se e kanë patur prej natyre. Kam parë njerzë, të cilët, me gjithë që hanë vetëm dy herë ditën, kanë po atë shëndet t' atyne, që stomaku i tyne si një zile alarmuëse, i thret katër a pesë herë në ditë në sofrë

Gjumi

Si do që kam thënë që fëmijvet, kur janë tepër të vegjël, t' u lihet mjaft kohë për gjumë e po thuaj të lihen të flenë sa kohë që të duan, me këtë nuk dua të them që edhe, kur të rriten, të kenë prapë po atë liri e të rrijnë shtritur në shtrat për të kënaqur instinktet e përtesës së tyre. Por, a do të jetë në moshën shtatë vjeç, dhjetë vjeç ase më vonë që do t' i vihet një kufi gjumit? kjo s' mund të caktohet pikërisht, pse duhet marrë parasysh shëndeti i tyre, fuqia e tyre dhe konstitucioni i tyre. Me gjithë atë mund të them vetëm, që ndërmjet moshavet shtatë vjeçë e katërbëdhjetë vjeç, t' i u shkurtohet pak nga pak koha e gjumit gjer më tetë orë, të cilat më duket mua, se janë të mijafta për qetësimin e trupit të djemvet të shëndetshëm. Në qoftë se i keni mesuar të çohen shpejt prej gjumit çdo mëngjes, sikurse duhet të bëhet, zakoni i të ndënjurit shumë kohë shtrirë në shtrat mund të ndërtohet shpejt; dhe më të shumat herë fëmijt vetë prej dëshirës që kanë të shkojnë pasdarkën në shoqëri duke bërë fjalë, e shkurtojnë kohën e gjumit. Shumë herë fëmijt çohen një herë, mbasandaj bien përsëri në gjumë, për këtë duhet të kujdesemi dhe të mos i lëmë kurrësesi që të flenë prapë. Duhet t' i zgjojmë rregullisht çdo ditë e ti forcojmë të ngrihen po n' atë orë të mëngjezit; porse duhet shumë kujdes që kur t' i zgjojmë të mos bëhet zhurmë e madhe ose t' iu vemi papandehur e t' iu bërtasim

Përbledhja

Të gjitha sa u-thanë mbi trupin e mbi shëndetin mund të mblidhen në këto pak rregulla të lehta për t' i vretur : erë e

pastërtë, ushtrime trupore, gjumë, ushqim i thjeshtë, pa verë e pirje të forta; pak ose aspak barëra mjekësije, mveshje që të mos jenë as tepër të ngushta, as tepër të trasha; më në fund duhet bërë zakon që kryet dhe këmbët të mbahen të ftohta, të iu bëhet banjë shumë herë me ujë të ftohtë dhe t' i rrahij lagështira.

G. Adem '30,

Provë mësimi dhânun në klasën e katërtë t' Ushtri- mores

**Thema : Gramatikë : Njoftim mbi njejsin dhe
shumsin e emnavet**

Natyrisht mësimi do të fillojë tue u-bâmun një hyrje e vullitshme, e cila ka për qëllim me i nxitë kureshtën dhe interesin nxânsvet, për mësimin qi do të bâhet sidomos tue marrun parasysh, gradën e zhviliimit menduer të 'tyne dhe tue u-mbështetun mbi gjânat qi gjinden në rrethin ma të afërm, pra ma të njoftuna prej 'tyne.

Hyrja pra e mësimi do të fillohet kështu : Pyeten disa nga nx. qi të tregojnë emnat e 'tyne; mbasandaj, si të përgjigjen nx. tue tregue disa emna njerzish, u thohet atëhere se të gjithë njerzit paskan nga një emën më vehte.

Mbasandaj u drejtohet kjo pyetje: por vetëm neve njerzit kemi emna? Kjo pyetje u-bâhet me qëllim qi të thonë se veç njerzvet edhe kafshët bashkë me sendet, kanë emna.

Kështu vetvetiu me ndihmën e nxânsvet del përkufizimi i emnit: Emni dëfteka njeri, kafshë edhe gjâ (send).

Mbasandaj këthehemi ke njejsi e ke shumsi i emnavet: Pyetet një nxânës, qi të tregojë emnin e ndërtesës ku mësojnë; mbazi të përgjigjet **Shkollë**, atëhere u-thohet se dytëti i jonë nuk ka vetëm një shkollë, por ka shumë **Shkolla**.

Sikurse ky sembull nxirren nga nxânsit me anë të pyetunash edhe shumë shembilla të tjera, herën e parë në njëjës e mbasandaj në shumus, të cilat shembilla përmbajnë shumsit e ndryshëm t' emnavet.

(Në të nxjerrunit e emnavet si shembull prej nxânsvet, duhet pasun kujdes qi të dâlin prej 'tyne jo vetëm emna, të cilët në shumus bâhen të gjithë nji soj, por të nxirren emna, të cilët në shumus, kanë trajta të ndryshme).

njeri	njerës	zog	zoq
shkop	shqepë	mik	miq
kaprull	kaproj	turtull	turtuj
pyll	pyje	mulli	mullij
ka	që	kal	kol
		mal	male

Gjithë këto emna të nxjerruna shkruhen prej mësuesit në dërrasën e zezë, si pasqyrë stërvitje për nxânsit, mbasandaj tue kërkue prap nga ato emna njejës dhe shumës të tjerë, të cilët u-përgjajnë këtyne.

Mâ në fund, mbassi të jenë marrë dhe disa emna të tjerë të ndryshëm, nxirret nga shembullat e paraqituna mâ përpara rregulla : **nji emën na dëfteka, jo vetëm nji gjâsend, nji kafshë, ose nji njeri, por edhe shum gjâsende, shum kafshë dhe shum njerëz.**

Pra paskemi, sikundër i thonë të diçmit, të cilët na e mësojnë gjuhën me e folë mirë e bukur, **njejës**, i cili na tregon vetëm nji njeri, nji kafshë oso nji send (gjâ) edhe **shumës**, qi na dëften, **shum njerës, shum kafshë dhe shum sende.**

Fjalët **njejës** dhe **shumës**, si edhe përkufizimet e tyne **mund** të fliten horas për ngulitjen e 'tyne sa mâ mirë në mendjen e nxânsvet.

Mbasi të kenë kuptue nxânsit njejsin e shumsin, atëhere ndahen dhe emnat, qi shkruen mâ parë si pasqyrë në dërrasën e zezë tue u-shkruem ke të parat fjala **njejës**, dhe emnat e dytë **shumës**. Kto fjalë shkruhen në kryet të emnavet dhe âsht mirë qi të shkruhen me shumës të kuq, sepse i bie mâ tepër në sy nxânsvet, kështu nuk i harrojnë kurrë numrat e emnit.

Mbasandaj bâhen stërvitje. tue u-dhânun nxânsvet emna të ndryshëm dhe tue i lânë qi të tregojnë numrin e 'tyne, ose tue u-dhanun emna në numrin njejës me i këthye në shumës, si edhe anasjelltas.

Në qoftë se del kohë, mbassi të kenë kuptue mirë numrat e emnit, mund t' u bâhet edhe nji përsëritje e shkurtën mbi

emnat e përveçëm dhe të përgjithshëm, të cilët i kanë pamë nxânsit më përpara; por tue pasun gjithmonë kujdes, qi të mos bëhet një mosdallim ndërmjet numrit t' emnit dhe llojit të tij.

Në fund t' orës u ipen nxânsvet disa emna në numrin njëjës me trajta të ndryshme, për me u-këthyem prej 'tyne në shumsa, si detyrë shtëpijake.

Shënim : Kjo orë përmbledh përgjithësisht njoftime mbi njësin e shumsin e emnavet; në orën tjetër përfiliten rregullat e shumsit të ndryshëm

B. Qorri *30.

RENATO FUCINI

Qysh u-bëra Prozator

Në një mbrëmje të vitit (mos më kërkoni datën pse të mbajturit mënd për mua është më e lartë nga fuqija e kujtesës s' ime të dobët)

Pra, një mbrëmje të vitit kaqë vajta me një shoqëri miqësh n' Antella, ku ishim ftuar për darkë nga zotërinjtë Ubaldino dhe Emilia Peruzzi. Miqtë qenë F. Genala, Edmondo De Amicis dhe Gustavo Uzielli.

Më 11 të natës i dhamë urdhër një shërbetori, që të lajmë-rojë karrocierin të gatitet për t' u-kthyer në Firenze.

Shërbetori vate po u-kthye sa kaqë të na thotë se kishte rënë gjer më 40 centimetro dëborë dhe që vazhdonte së rëni edhe. Për ikje s' qe për të bërë fjalë. Për mua sidomos që kisha një gjumë kusar dhe për shokët e mij që një mos kënaqësi. Për zonjën Emilia që një kënaqësi e madhe dhe e shfaqti duke duartrokatur me gëzim e duke na thënë se, me qenë se do shkonim atje mbrëmjen edhe tërë natën do t' i jepesh rasë asajt' u përgjegjesh shumë letrave që i ishin bërë tok mbi tryezë.

Pas një orë (ishte mes' i natës) unë kisha mbaruar punën t' ime dhe u-ngreçë të shkoja për gjumë. Nuk që e mundur të mirrje leje si nga zonja Emilia ashtu dhe nga shokët e mi.

— Po përse doni të më mbani, kurse nuk kam gjë tjetër për të bërë ?

— Këndo.

— Nuk mund të mbaj dot syt hapur.

— Shkruaj.

— Kaqë më shumë! Ç' të shkruaj?

— Shkruaj parathënjen për librin e vjershavit.

Ato ditë qenë shtypur vjershat e Pellas. Do t' u thoshnja kush' e di ç' sharje atyre njerzëve të dashur e të mirë; por u mbajta, vura buzën në gaz dhe u-vura të shkruaj parathënien.

Pas pak minutave nxora një parathënje, të cilën ua këndova miqvet.

Me një zë nuk u-pëlqye. E çora atë dhe bëra një tjetër. Edhe e dyta pati suksesin e së parës. E gjithë atë sukses pati edhe e treta, dhe nuk desha të shkruaj më.

Ora për të fjetur kishte ardhur. por më parë se ngriheshim u-hap një bisedim i vogël mbi përpjekjet e mija për prozë dhe m' u-hoq vrejttja miqësisht që, unë, kaqë i derdhur në të shkruar vjersha, në prozë shkruaja keq e me mundim.

Vajta të flëja me një gjëmb në zëmër e me një **amor proprio**; dhe u-vura të shkruaj edhe në prozë. Fillova të shkruaj për çdo gjë nga pak: kallzime, komedira, romanca, tragjedira dhe të gjitha i grisja pas pak fletëve edhe filloja përsëri me një ngulje, që nuk që e natyrës s' ime; dhëmbja e gjembit në zëmër që aqë e fortë, sa që nuk u-ndala gjer sa shkrova: "I marri i Kallamesë (¹)

V. Nasto "30."

(¹) Një nga novellat e librit "Le veglie di Neri".

Rreth ditës së Flamurit.

Në zemrat e nxânsve t' Internatit të Normales, si në zemër të çdo Shqiptari, në këte ditë vlonte një gëzim i madh e ky gëzim u-përzi me dhimë, dëshirë e shpresë, kur në kohën e drekës disa nga nxânësit e rendeve të fundit me fjalë të mallëngjyeshme, të thekëshme e të madhnueshëmë prekën zemrat e tyne.

Para buket një herë muer fjalën Koleci Sefedin 31, i cili theksoi gëzimin qi ndiejne Shqiptarët në këte ditë dhe helmin për vendet e robnueme. Mbas buket në mes duertrokitjeve filloi Spahiu Rifat 30, i cili s' parit përmendi randësin e ksaj dite në lidhje me zgjedhën mizore të Turkis, qi mbajti aqë shumë; mandej

bani fjalë mbi vendet e robnueme, të cillat vëjnë e lotojnë nën thundrën e të huejvet, kur na gëzohemi e brohorisim në tokë të lirë. I dha fund fjalës tue theksue randësin në lamë t' edukatës kombëtare: " Atëhere — tha — do të pshtojë Kosova e Çamëria, kur të zgjohen në djelmënin Shqiptare ndjenjat si ke frengjit, kur Alçari gjindej në dorë të Gjermanis, kur të shënojnë d. m. th. djelmohat Shqiptarë vendin e Kosovës e të Çamëris në zemrat e tyne e jo kurr në tokat greke e jugosllave. Barra më e randë në lamë t' edukatës kombëtare i bien mësuesit të fillores, se ky e ka në dorë dhe do ta gatuejë brumin e ri, e, për me ia mbrijtë idealit të 'tij të shëjtë, lypset të punojë me gjithë fuqi, si i ka hije një mësuesi t' aftë, një mësuesi në kuptimin e vërtetë të fjalës, një mësuesi të shekullit XX „.

Mbas këtij nisi Andoni Sotir 30, i cili, si përmendi vëjtjet e papreme të Shqipëtarëve, shtoi: " Jeta e Shqiptarit në çdo kohë ka shkëlqyem si drita me trimnin e 'tij dhe kurr s' ia ka përkulë kryet të huejit, por ka qindrue zot në vehte „. Foli mbi veprën e madhueshëme qi kreu Ismail Qemali, i cili qe frymzue prej doktrinës kombëtare të Naim Frashërit. Në fund dëftoi shpresën se Shqipnia nën Zogun e parë do të shofi ditë më të mira; " e dhantë Zoti — tha — qi flamuri i ynë me kohë të valojë n' orizontin e gjithë Shqipnis Etnike „.

Fjalimet i mbylli Pali Zef 30, i cili, si përtirini në shpirt të ndigjuesve nderimin për gjakun qi derdhën Shqiptarët për liri, theksoi se, për të vijue Shqipnia jetën qi ka nisë përherë më me lumni, lyp **punë** e **jo fjalë**. U tha shokëve se edhe ato lypset të përpiqen e t' i kushtojnë gjith fuqit e tyne Atdheut për të formue Shqiptarë të mirë e të vërtetë. Ndër sa tjera mbi punën qi do të bëjnë mësuesit e tashëm dhe t' ardhshëm tha edhe këtë: " T' afrojmë shpirtin e nxënësve kah nana Shqipni, qi të nxënë me e njoftë, me e nderue e me i kushtue asaj gjithë energjit e tyne e me i bënë të quhen djelm të vërtetë të 'saj. Prej nesh do të mësojnë sa gjë e mirë është me ndjekë udhën e vërtetit, sa gjë e madhe me qenë apostujt e të vërtetës, sa gjë e shëjtë me sakrifikue vehten për të mirë të njeni tjetrit. Në fund theksoi mjerimin e Shqipnis së robnueme, e mësuesin shpëtimtarin e 'saj.

Në mes të duertrokitjeve të shuma muerën fund fjalimet, të cillat lanë një mbresë të thellë në shpirt të ndigjuesve.

“ Kush duron, trashëgon. „

(Victor Hugo „)

“ As gjâ nuk âsht e pamundun për njerin që duron. „

(Mirabeau-i)

“ Kush duron deri në fund, ai i shpëtuem ka me qenë „

(Jesu Krisht.)

Përpara se ta pranojmë një gjâ, duhet ta gjykojmë; kjo âsht një pikë kryesore e detyrës së njeriut; mirëpo vetëm me të gjykuemit nuk mbarohet puna, po nuk u-bashkue me të durimi, i cili âsht gjaja e dytë e detyrës s' onë.

Mungesa e durimit ka qenë shkakun kryesuer i milionvet të rij, që të mos ia marrinë qëllimit, edhe mendimet e 'tyne janë bâmun për tallje e për të qeshun dhe vehten e kanë bâmë që të mos çmohen aspak prej të tjeret.

Nga historia e vjetër e Greqis mësojmë se Demosteni donte të bâhesh orator, por kishte dy të meta, të cilat e bâjshin publikun me qeshun, kur ai fillonte të mbante ligjeratë. Atij i mbahej goja edhe mblidhte sa njenin sup, sa t' jetrin. porse nuk mërzi-tesh. Për me i largue të metat shkante në bregun e detit edhe mbushte gojën me zaje të vegjël edhe kështu me zâ të naltë fliste mbi poteren e valës gjithë ditën. Në shtëpi rrinte nën dy hostena të mprefme afër supeve, qi, kur t' i luente të shpohej. Pas pak kohë Demosteni u-bâ oratori mâ i math, jo vetëm i Greqis, por edhe i gjithë botës, edhe populli interesohesh shumë me ndëgjue ligjeratën e 'tij.

Dizraeli ishte pritun me tallje e me të qeshun, kur mbajti ligjeratën e parë në parlament. Përgjigja e 'tij ishte: “ do të vijë koha që do të dëshëroni të më dëgjoni „. E me të vërtetë ai u-bâ mâ von kryeministri i përmendun i Anglis.

Njeriu me durim kapërcen çdo pengim; punon me zell edhe në qoftë se nuk fiton nga puna, ai ia këthen durimit.

Në betejen e Marengos francezët e kishin humbun luftën edhe të gjithë pritshin urdhën për me u-prapsun, por Napoleoni pa orën edhe tha: "Këtë beteje e kemi humbun fare, por ka edhe dy orë dhe ne kemi me pasë kohë me fitue t' jetër „. Dha urdhën: " përpara „ edhe qëllimi i 'tij usplotësue.

Atë durim donte edhe Sir Isaac Nywton, qi t' i jepte botës rezultate nga ditunia e 'tij, të cilën me durim të math e me vullnet të fortë e çfaqti tue e shkruie për s' dyti në librin e 'tij, mbassi s' pari, kur ishte tue i dhënë fund, qeni ia derdhi ngjyrën e ia zhgreu.

Karlajl ia dha dorëshkrimin e 'tij mbi revullucionin e Françës nji mikut, i cili nuk ia këtheu mâ, po fillosofi plak i u-kërus punës edhe e filloi prap tue e shkruie mâ bukur se të parën.

Kështu pra, historia është e mbushun me të këtilla shëmbëlla të cilat na japin të kuptojmë se nevoja e nji durimit të fortë për ne është e domosdoshëme edhe mësimin mâ të mirë e marrim prej atyne, që kanë kalue jetën tue bâmun punë të mëdha vetëm me anën e durimit.

St. Spasse *32.

Andej-këndej

Të përshëndeturit

Përse përshëndetim ne, për detyrë? për të qënë në për-pjekje me t' afërmin t' onë? për të shfaqur kënaqësin ose për të fshehur mërin t' onë?

Puna e të përshëndeturit është shumë e ngatëruar; është abecejë e edukatës së të gjithë popujve dhe rrëfen shkallën e qytetërimit të tyre.

Cili njeri qe ai që deshi t' i japë njeriut për të parën herë këtë shënjë sympathie reciproke, e cila më pas me përmirësimin e racave u-bë një hypokrisi? Të përshëndeturit ka qënë i gjithë kohëravet e i gjithë botës. Edhe Engjelli, kur vate i lajmëroi Marisë ëmësin, e përshëndeti " Zoti të shpëtoftë, moj Mari „.

Në kohën e Mesme asnjë dyluftim nuk fillonte pa përshën-

detur kundërshtarët kalorisht me shpatë.

Ato kohëra shkuan shumë larg. Të përshëndeturit e kohës së sotme ka marrë një ngjyrë tjetër. Humbi shumë nga shquarësia e hollësia e shkuar dhe shumë nga kuptimi poetik e heroic.

Sot, kundërshtarët, nuk përshëndeten më kalorisht sikurse në kohërat e para, që me armë të barabarta, ishin në të hedhur e sipër.

Shtërëngimi i dorës së sotme, e prishi përshëndetin konvencionale të kohës së shkuar. Dora ndoret, shtërëngohet dhe hiqet mekamikisht, automatikisht.

Thuajmë se si përshëndet, të të them se ç' njeri je! Nga salutimi i parë, në formojmë një ide mbi edukatën, gjëndjen shoqërore e kulture të një njeriu, si edhe mbi karakterin e tij, pse në të përshëndetur njeriu, pa kuptuar, shfaq personalitetin e tij.

Kush saluton shpesh, është njeri shoqëror. Ka një shquarësi të veçantë, e cila fitohet me zakon e me pjekje të përditëshme me njerës e me kulture të virtytshëm.

Kush zë dorën pa e shtërënguar, është një njeri egoist; kush e lëshon me mahni është zemër ngushtë.

Shtërëngimi i nxehtë i dorës, dëftën njerin qejfli dhe zemër bardhë.

Vangjel Nasto

Lajme Sportive

Këte vit si në çdo gjë që ka pasë shkolla e jonë ndryshime e përparime, ashtu edhe në sport është pa një përparim i math. Me inisiativën e profesorit të ri të gjymnastikës, Z. P. Andoni, e me vullnetin e 'tyne filluen nxënësit me lëvizë mbas një pushimi tre mujsh. Skena sportive u-hap së pari me lojnat e foot-ball-it ndërmjet rëndevet, për t' u-fitue pariya në këte lojë. Qysh prej 1/XI/1929 fusha e sportit, po thuej se çdo ditë, ishte e mbushun me nxënë të rëndevet të ndryshëm e me lojtarë, që mundloheshin me qitë faqebardhë rëndin e 'tyne; këto lojna zgjatën deri më 24/XI/1929, pse prej kohës së ligë rrallë herë nxënësit ishin të shtërënguem mos me e fillue lojën. Nga këto lojna u-pa se rëndet e naltë, si më të mëdhej, ishin edhe më të fortë; por me gjithë ate edhe nga rëndet e ultë kishte mjaft lojtarë të zottë, të cilët, me gjithë që janë të vegjël, por me teknikën e dëshirën e 'tyne për foot-ball shpresohet që të bëhen lojtarë fare të mirë e

qi mund t'ja zbardhin faqen shkollës së 'tyne në çdo rasë. Përfundimi i aktit të parë të skenës sportive merret vesht nga kjo tabellë :

Rendet	Pikët	Fitoi	Baraz	Humbi
Rendi i IV	350	3	1	—
" " V	300	2	2	—
" " II	300	2	2	1
" " III	150	1	1	2
" " I	100	1	—	3
" Gatimuer	000	—	—	4

Përpara se të nisin këto lojna, u-luejt një match tepër interesant ndërmjet Elbasanit e Internatit të Shkollës, në të cilin Elbasani fitoi; përfundimi qe 1 me 0. Kjo lojë u-përsërit edhe një herë ditën e 28 Nandorit edhe përfundimi qe po ai i pari.

Më 22/XI/1929 u-bënë provat e para për Cross country (3000 m.), qi do të bëhet ditën e festimit të themelimit të Shkollës ndërmjet rrendvet, për të fitue parin edhe në këte.

Mbas këtyne do të fillojnë edhe lojnat e Basket ball-it e të voley-ball-it ndërmjet rrendvet e prej përfundimevet të të gjithë këtyne lojname do të zgjidhen grupet e parë të shkollës, të cilët mund ta përfaqësojnë shkollën në çdo rasë.

Nga mbarimi i vitit shkolla do të api një çfaqje sportive, ku do të marrin pjesë të gjithë nxënësit; për këte këta kanë fillue me u-shtruar deri ndashti.

Akti i fundit i skenës sportive do të jenë lojnat atletike, qi do të bëhen në fushën e sportit, për të cilat nxënësit kanë fillue me dëshirë të madhe m' u-stërvitë; prej këtyne lojname do të dalin atletët më të mirë të kësaj shkolle, të cilët do ta përfaqësojnë shkollën në çdo lojë atletike, qi mund të bëhet në Shqipni.

Kur t' u shpërndahen medaljet fituesve, do t' ipet edhe një kupë rendit, qi është tregue nëpër lojnat më i urtë, më i bindëshëm e më i sjellshëm, d. m. th. atij qi ka lojtarë qi janë me të vërtetë njerzë të sportit.

Gjithë këto gjana duen punë e jo fjalë nga profesori e dëshirë e vullnet të fortë nga nxënësit, qi të kryhen ashtu si u ka hije e besoj se kanë për të pasë suksesin më të math, pse një shpirti Shqiptar nuk i mungojnë këto cilsit sportive.

A. Andoni "29,"

Z. z. Pajtimtarëvet t' onë

Kushti mâ i parë që përmba, shton e përmirëson një të përkohëshme, është pasunia landore e aqë mâ tepër forcohet ky kusht, kur ajo është sidomos një botim nxënësish. Edhe ne, tue shpresue se të gjithë pajtimtarët, porsa të mirrte fund botimi i Normalistit për vitin e parë, do ta shpaguejshin, bëmë mend për me e përmirësue e me e shtue pak; por për çudi shumë pajtimtarë s' e kanë plotsue enle detyrën e 'tyne ndaj "Normalistin", botimin e parë të nxënsvet të Shkollës Normale.

Edhe në numrin e mâ përpashëm u patëm bñ një kërkesë pajtimtarvet t' onë; këte po ua përsërisim përsëri dhe besojmë me siguri se, porsa ta marrin këte numër të vitit të dytë, kanë me na këthye pajtimin e vitit të parë, aqë të nevojshëm për këte të përkohëshme.

Gjithashtu u lutemi shumë të gjithë atyne zotnive, që iu ka ngarkue barra me u-kujdesë për punë të Normalistit, të kujdesen për sa u-thënë nalt e një ato që të mbledhin t' na i dërgojnë sa mâ parë bashkë me emnat e atyne që kanë pague.

Shpresojmë se si të parët, ashtu edhe të dytët s' kanë me u-kursye aspak e kanë me e plotsue këte, që po kërkon Normalisti prej 'tyne.

Drejtuesit

Z. z. Pajtimtarëvet t' onë

Kushti mâ i parë që përmba, shton e përmirëson një të përkohëshme, është pasunia landore e aqë mâ tepër forcohet ky kusht, kur ajo është sidomos një botim nxânësish. Edhe ne, tue shpresue se të gjithë pajtimtarët, porsa të mirrte fund botimi i Normalistit për vitin e parë, do ta shpaguejshin, bëmë mend për me e përmirësue e me e shtue pak; por për çudi shumë pajtimtarë s' e kanë plotsue en le detyrën e 'tyne ndaj "Normalistin", botimin e parë të nxânsvet të Shkollës Normale.

Edhe në numrin e mâ përpashëm u patëm bñ një kërkosë pajtimtarvet t' onë; këte po ua përsërisim përsëri dhe besojmë me siguri se, porsa ta marrin këte numër të vitit të dytë, kanë me na këthye pajtimin e vitit të parë, aqë të nevojshëm për këte të përkohëshme.

Gjithashtu u lutemi shumë të gjithë atyne zotnive, që iu ka ngarkue barra me u-kujdesë për punë të Normalistit, të kujdesen për sa u-thânë nalt e një ato që të mbledhin t' na i dërgojnë sa mâ parë bashkë me emnat e atyne që kanë pague.

Shpresojmë se si të parët, ashtu edhe të dytët s' kanë me u-kursye aspak e kanë me e plotsue këte, që po kërkon Normalisti prej 'tyne.

Drejtuesit

